



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 221, Datë 11.10.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENER TRADE”
SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “ç”, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1 gërma “d”, dhe nenit 10, pika 3 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 11.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ENER TRADE” shpk, në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 628 Prot. datë 03.10.2018, shoqëria “ENER TRADE” shpk, ka paraqitur në ERE kërkesën për tu pajisur me licencë në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike.
- Aplikimi i shoqërisë “ENER TRADE” shpk, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1). Plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “e”). Plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3). Plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike (neni 9 pika 4.7 dhe 4.7.1). Plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Nenin 9 pika 2, gërma ”d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata), do t’i kërkohet subjektit që në bazë të nenit 11 pika 1 të “*Rregullores për Proçedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ENER TRADE” shpk, në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI